



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21654 Prot.

Lezhë, më 18.12. 2025

VENDIM

Nr. 121, Datë 15. 12. 2025

**Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare Znj.Nurije Medja për djegie banese**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**Vendosi:**

1. Akordim ndihme financiare për znj. Nurije Medja me Nr ID.F85504068D, banore në lagjen "Skënderbeg" Bashkia Lezhë, në shumën prej 147,548 lekë për djegie banese.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



Nr. 21654/, Prot  
Dt. 25-12-21

K.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK



Nr. 1249/8 Prot.

Lezhë, më 24.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2/b, të ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", në VKM nr.329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.121, datë 15.12.2025, "Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare znj.Nurije Medja për djegie banese."

PREFEKTI

Taulant MALSHU

